

PROCESVERBAL
nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 2.3.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dr. Zoran Trajčevski.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunovi, dr. Ivana Stojanovska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 9-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 15:40 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Në lidhje me propozimin e rendit të ditës, kryetari Stefanovski, sqaroi se Pika nr. 5 – "Propozim- vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Prva Skopska TV SHPK Shkup (TV MTM Shkup)" - riemërtohet në "Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Prva Skopska TV ShPKNjP Shkup (TV MTM Shkup)", duke pasur parasysh që transmetuesi ndërkohë i ka përmbushur detyrimet e përcaktuara ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 26.2.2026.
2. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio 99 ShPKNjP Shkup.
3. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV-EDO ShPKNjP, fsh.Ljubin, Saraj.
4. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShKNjP.

5. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Prva Skopska TV ShPKNJ P Shkup (TV MTM Shkup).
6. Propozim për dhënien e miratimit për plotësimin e Planit vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-5639/1 datë 26.12.2025.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – të shërbimit: bileta avioni.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 26.2.2026, dhe njëzëri miratoi tekstin e propozuar.

Pikat 2, 3 dhe 5

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, informoi se në lidhje me Pikat 2, 3 dhe 5, do të japë shpjegim të përbashkët, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për shkelje të njëjtë të dispozitës së ligjit, pas së cilës Këshilli do të vazhdojë me deklarin e tyre dhe do të votojë për secilën pikë. Ai shpjegoi se tre transmetuesit – ShTR Radio 99 ShPKNJ P Shkup, ShTR TV-EDO ShPKNJ P fsh.Ljubin, Saraj dhe ShTR Prva Skopska TV ShPKNJ P Shkup – në afatin shtesë të përcaktuar me ligj prej 15 ditësh kanë paguar kompensimin vjetor për transmetim televiziv përkatësisht radio. Duke pasur parasysh këtë, propozohet që Këshilli të miratojë aktvendime për ndalimin e procedurave të inicuar.

Votimi për Pikën 2

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio 99 ShPKNJ P Shkup, PA1 nr. 0802-37 datë 7.2.2024.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-636/2 të datës 24.2.2026, transmetuesi ka paguar kompensimin vjetor plotësisht, në përputhje me faturën nr.2026-100-0026 të datës 12.1.2026.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit është i detyruar që Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për Pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV-EDO ShPKNJ P fsh.Ljubin, Saraj, PA1 nr.08-14 të datës 7.9.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-697/2 të datës 26.2.2026, transmetuesi ka paguar kompensimin vjetor plotësisht, në përputhje me faturën nr.2026-100-0008 të datës 12.1.2026.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit është i detyruar Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për Pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Prva Skopska Televizija ShPKNJ P Shkup, PA1 nr.08-16 të datës 7.9.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-634/2 të datës 2.3.2026, transmetuesi ka paguar kompensimin vjetor plotësisht, në përputhje me faturën nr.2026-100-0010 të datës 12.1.2026.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit është i detyruar Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Drejtori Trajçevski shpjegoi Propozim-aktvendimin për fshirjen nga Regjistri i radiodifuzerëve të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNJ P, duke shpjeguar se transmetuesi ka kthyer vullnetarisht lejen për transmetim në radio. Në pajtim me ligjin, duke pasur parasysh se nuk posedon leje të vlefshme, është e nevojshme që të fshihet nga Regjistri i radiodifuzerëve, me ç'rast procedura konsiderohet e përfunduar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit është i detyruar që Aktvendimin ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6

Drejtori Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për plotësimin(ndryshimin) e Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr.05-5639/1 të datës 26.12.2025. Ai shpjegoi se gjatë vitit 2025, furnizimi publik për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit është shpallur tre herë, por në të tre rastet procedura ka përfunduar si e pasuksesshme, për shkak se asnjë operator ekonomik nuk ka paraqitur ofertë për pjesëmarrje. Duke pasur parasysh se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Ministria e Sportit kanë nevojë për shërbimin e paraqitur(cituar), i cili është i nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të përditshëm të punës, propozohet plotësimi i Planit

për furnizime publike për vitin 2026, në mënyrë që procedura të zbatohet gjatë këtij viti.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për plotësimin e Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2026, nr.05-5639/1 të datës 26.12.2025, me tekstin e propozuar.

Plani vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-5639/1 të datës 26.12.2025, plotësohet me furnizim – të shërbimit: mirëmbajtje dhe servisim të sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit

Me plotësimin e propozuar, mjetet e nevojshme për realizimin e furnizimit janë siguruar, përkatësisht do të sigurohen gjithashtu sipas mënyrës në vijim:

- 760.000,00 denarë, në Planin Financiar për vitin 2026, dhe
- 760.000,00 denarë, në Planin Financiar për vitin 2027.

Plani vjetor ekzistues për furnizime publike për vitin 2026 i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr. 05-5639/1 të datës 26.12.2025, plotësohet si në vijim:

- Kapitulli II. Kontratat dhe marrëveshjet kornizë për furnizimin publik të mallrave, plotësohet me furnizimin publik në vijim: Mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit, si pika nr. 43, përkatësisht:

p.	Lënda e kontratës për furnizim publik/marrëveshja kornizë	Lloji i kontratës për furnizim publik	Lloji i procedurës	Fillimi i prituri i procedurës (muaj)	Vlera e parashikuar e furnizimit/marrëveshjes kornizë pa TVSH (denarë)
I.	Kontratat dhe marrëveshjet kornizë për furnizime publike të shërbimeve				
3.	Mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit	shërbim	procedurë hapur thjeshtuar	e sipas nevojës	1.520.000,00

Duke shtuar furnizimin e lartpërmendur do të kryhet harmonizim në mënyrë të përshtatshme me furnizimin e përfshirë në Kapitullin III. të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2026, nr.05-5639/1 të datës 26.12.2025.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike është i detyruar të përgatisë tekst të pastruar të Planit vjetor për furnizime publike të Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizimit publik – të shërbimit: bileta avioni. Ajo shpjegoi se propozimi është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë, ndërsa mjetet për realizimin e furnizimit janë

siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2026. Furnizimi do zbatohet për nevojat e udhëtimeve zyrtare gjatë procesit të punës dhe realizimin e tyre në kohë. Në pajtim me vlerën e parashikuar, procedura do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar. Do të fillojë me shpalljen në Sistemit elektronik për furnizim publik, si dhe me publikimin e njoftimit në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", me ç'rast do të respektohen të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Informacione më të hollësishme përmbahen në materialet e paraqitura sipas kësaj pike.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: bileta avioni.

Zbatimi i procedurës është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr.05-56391/1 të datës 26.12.2025, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**